



## Thirrje për Web Designer

Është një **thirrje e hapur** për web designer (person fizik ose juridik), i/e cila do të krijojë një hapësirë specifike brenda faqes zyrtare të organizatës, dedikuar mundësive të arsimit të lartë, zhvillimit profesional të të rinjve si dhe mundësitë për punësim. Thirrja është hapur në kuadër të projektit “Steps to youth resilience and empowerment - SYRE” i mbështetur nga Projekti i Mbrojtjes Sociale pas Tërmetit i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)

Data e publikimit:

**19/01/2022**

*SHOQATA Udhëtim i Lirë - LIBERI DI VIAGGIARE*

Rr. “Egnatia” Nr.109 – 2001 Durrës (Albania)

[www.udhetimiilire.org](http://www.udhetimiilire.org) Email: [info@udhetimiilire.org](mailto:info@udhetimiilire.org); [udhetimiilire@gmail.com](mailto:udhetimiilire@gmail.com)



## **Prezantim**

Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, joqeveritare, jopolitike dhe e hapur për të gjithë ata që punojnë për realizimin e qëllimeve të saj. Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” është një shoqatë e themeluar në Durrës, Shqipëri me qëllim zhvillimi dhe menaxhim turizmi, të trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale dhe më gjerë me fokus në zhvillimin rajonal në fushat e sipërpërmendura dhe ato të ndërsjellta. Ky qëllim është në përputhje me strategjitë e Republikës së Shqipërisë në fushën e turizmit dhe të trashëgimisë kulturore si dhe me Kartën Europiane të Zhvillimit dhe të autonomisë rajonale.

Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” ka fituar projektin “**Steps to youth resilience and empowerment - SYRE**” i mbështetur nga Projekti i Mbrojtjes Sociale pas Tërmetit i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Në kuadër të këtij projekti do të krijohet një hapësirë në faqen zyrtare të organizatës e cila do të përmbajë informacione në lidhje me mundësitë e arsimit të lartë, kurset profesionale dhe mundësitë për punësim. Informacioni do të jetë i aksesueshëm nga të gjithë, të rinjtë dhe të gjithë të interesuarit. Në të njëjtën kohë kjo hapësirë do të përmbajë informacione mbi fatkeqësitë natyrore dhe strukturat ku mund të drejtohen individët për ndihmë. Shoqata do të kontraktojë personin fizik ose juridik i/e cili/a do të zgjidhet përmes këtij procesi tenderimi, i/e cili/a më pas do të bëjë hedhjen e materialeve në web.

## **Qëllimi i Thirrjes**

Synimi i përgjithshëm i thirrjes është përzgjedhja e një specialisti/e (person fizik ose juridik) në fushën e web designer i/e cili/a do të krijojë hapësirën dedikuar mundësive të arsimit të lartë, kurseve profesionale dhe mundësitë për punësim në faqen e shoqatës.

Personi (fizik ose juridik) i kontraktuar do të bëjë gjithashtu hedhjen dhe pasurimin e informacionit dhe do të kujdeset për mbarëvajtjen e hapësirës.



## **Qëllimet e Projektit**

Fuqizimi psiko-social dhe ai ekonomik i të rinjve vulnerabel, në Bashkinë Durrës të prekur nga tërmeti. Aktivitetet e dizenuara i referohen dy kategorive kryesore, të rinjve dhe prindërve në familjet e prekura nga tërmeti i nëntorit 2019.

### **Objektivat specifik:**

- 1) Të ndërtojë aftësi jetësore dhe të promovojë rehabilitimin dhe reziliencën tek të rinjtë vulnerabël, duke zhvilluar aftësitë për të marrë vendime dhe planifikuar për të ardhmen.
- 2) Pajisja e të rinjve me kompetencat përkatëse si njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe kompetenca sociale, organizative dhe personale për të ardhmen.
- 3) Të facilitojë zhvillimin e kurseve profesionale të të rinjve dhe mundësinë për punësim.

### **Data dhe Vendi:**

Aktiviteti është parashikuar të fillojë në tremujorin e tretë të projektit (Shkurt – Prill 2022) dhe të përfundojë në tremujorin e katërt (Maj-Korrik 2022).

### **Profili i kërkuar i Web Designer:**

- Diplomë Universitare; Studime pasuniversitare (Dega IT/Web Developer/ Web Designer)
- Eksperienca të mëparshme në përgatitjen dhe dizajnimin e faqeve të organizatave.
- Njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Aftësi të mira në përpunimin e të dhënave për shikueshmërinë e faqes dhe përgatitjen e raporteve.

### **Web Designer pritet të ketë:**

- ✓ Aftësi shumë të mira në gjuhën shqipe/ angleze: aftësia për të krijuar dhe mirëmbajtur faqe online.
- ✓ Aftësi të mira për të publikuar dhe organizuar materiale në faqe.
- ✓ Përvojë thelbësore për të përpunuar materialet që do të publikohen në web.
- ✓ Dëshirën për të bashkëpunuar dhe koordinuar punën me stafin e projektit dhe shoqatës.



- ✓ Njohuri dhe përvojë në fushat relevante të TIC .
- ✓ Shkathësi kompjuterike adekuate.
- ✓ Aftësi për të punuar në mënyrë konstruktive në një ekip.

***Numri i personave që do të përzgjidhen:***

Për këtë qëllim Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” do të kontraktojë **1 ekspert/web designer (person fizik ose juridik)**.

***Kontratat dhe Tarifat***

Personi (fizik ose juridik) i përzgjedhur do të ftohet për të nënshkruar një Kontratë Shërbimi me Shoqatën “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare”, Durrës. Kontrata do të lidhet në LEK. Pagesa do të bëhet në dy këste pas përfundimit të detyrave të përfshira nga caktimi i Shoqatës “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” Durrës, është përgjegjës për pagimin e të gjitha taksave që lidhen me këtë detyrë.

***Numri i ditëve të punës:***

- **Krijimi i hapësirës së dedikuar: 1 ditë**
- **Hedhja e materialeve në web: Muaji Shkurt-Mars-Prill**
- **Vlerësimi dhe Raportimi: 1 ditë**
- **Përpunimi i të dhënave: 6 ditë në total**
- **Totali: 8 ditë**



## ***Procesi i Aplikimit***

### *Dorëzimi i dokumenteve*

Kandidatëve të interesuar (fizik) u kërkohet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. CV në Shqip (preferohet në modelin Euro Pass).
2. Kopje të diplomës dhe kualifikimeve të tjera
3. Një letër në të cilën:
  - Jep shembuj konkretë se si përvoja dhe aftësitë e aplikantit përmbushin detyrën (bazuar në kriteret e listuara për profilin e trajnerëve);
4. Ofroni informata nga dy referenca të cilët mund të kontaktohen nga Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare”.

Kandidatëve të interesuar (juridik) u kërkohet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. NIPT
2. Ekstrakt Historik
3. CV ose Portofol të ekspereincave të mëparëshme

Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve në thirrjen aktuale për trajnerin është 29 Janar 2022, ora 17:00 CET.

Dokumentet do të dërgohen në [info@udhetimiilire.org](mailto:info@udhetimiilire.org) dhe/ose [udhetimilire@gmail.com](mailto:udhetimilire@gmail.com)

Ju lutemi tregoni në e-mail tekstin e mëposhtëm: Aplikimi për Thirrje për Web Designer për projektin “**Steps to youth resilience and empowerment - SYRE**”.

## ***-Kriteret e përzgjedhjes***



Web Designer (person fizik ose juridik) do të përzgjidhet nga komisioni i përzgjedhjes i përbërë nga stafi i Shoqatës “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare”. Procesi i përzgjedhjes do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga thirrja aktuale për web designer.

Aplikimi i paraqitur pas afatit nuk do të konsiderohet për vlerësim dhe përzgjedhje.

Çdo aplikim do të gjykohet sipas kriterëve të sipër përmendura.

***Preferohen ekspertë/trajnerë nga Durrësi.***

## ***Kalendari indikativ i thirrjes***

<b>AKTIVITETI</b>	<b>AFATI</b>	<b>KOHA</b>
Lancimi i thirrjes	19 Janar 2022	12:00 CET
Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve	29 Janar 2022	17:00 CET
Informacion mbi përzgjedhjen	31 Janar 2022	17:00 CET

Ky afat kohor mund të përditësohet nga Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” Durrës gjatë procedurës. Në raste të tilla, orari i azhurnuar do të publikohet në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të Shoqatës “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare: [www.udhetimiilire.org](http://www.udhetimiilire.org)

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë Thirrje për Web Designer , ju lutemi kontaktoni në adresën e e-mail: [info@udhetimiilire.org](mailto:info@udhetimiilire.org) dhe/ose [udhetimilire@gmail.com](mailto:udhetimilire@gmail.com)